**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KUVENDI I KOMUNËS
# KOMITETI PËR KOMUNITETE

**Procesverbal nga mbledhja e III-të (tretë - mandati VIII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 18 shtator 2026**

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10:10
Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Xhafer Ademit Kryesues i Komitetit për Komunitete.
Fillimisht u vërtetua se në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët e këtij Komiteti dhe atë:
z.Ardi Hasani; znj.Vlora Jashanica; znj.Blerta Azemi-Berisha; z.Besim Latifi; z.Demokrat Hodolli; z.Rrhaim Sejdiu; znj.Vlorjana Avdiu; z.Xhafer Ademi; znj.Dorontina Tahiri; z.Muhamet Sadiku; znj.Sevdije Mustafa.
Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm tjerë ishin: z.Fahri Restelica Nënkryetar i Komunës; z.Liman Zeqiri shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK; z.Ardian Emini zyrtar në Drejtorinë e Arsimit; z.Driton Shabani nga Stacioni i Policisë në Podujevë; përfaqësues të KFOR.

## Rendi i ditës

**z.Xhafer Ademi**, **Kryesues i Komitetit,** e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, theksoi, sot kemi mbledhjen e dytë të Komitetit për Komunitete e cila është thirr me këtë rend të ditës (lexon pikat e rendit të ditës), andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim kështu siç ju është dërguar.

*Njëzëri me 10 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit për Komunitete që ishin prezent, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.*

1. **Procesverbali nga mbledhja inauguruese e mbajtur më 18 gusht 2026**

*Pas votimit, Njëzëri me 11 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit për Komunitete, u konstatua se miratohet, pa vërejtje apo plotësim ndryshime, Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 18 gusht 2026*

2. **Informatë nga Drejtoria e Arsimit rreth fillimit të vitit shkollorë 2026/27, me theks regjistrimi i nxënësve të Komuniteteve jo shumicë, sfidat dhe vështirësitë**

**z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit**, theksoi, para se të marr fjalën përfaqësuesi i Drejtorisë së Arsimit, të njëjtin e ftoj që të na jap informacione lidhur me arsimin e sidomos për komunitetet në Komunën Podujevës, ku përveç kësaj sot do ta caktojmë edhe një datë për vizita në shkollat e Podujevës me qëllim që të shihet gjendja reale e nxënësve të komunitetit se sa janë regjistruar, a ka ndonjë që e ka braktisë shkollimin, si dhe punët dhe problemet tjera, prandaj pa humbur kohë i'a kaloj fjalën përfaqësuesit nga Drejtoria e Arsimit.
**z.Ardian Emini**, zyrtar në DKA-Podujevë, duke paraqitur Informatën në fjalë, theksoi, në vazhdën e fillimit të vitit të ri shkollor, ne Drejtoria e Arsimit në vitet e kaluara por edhe në këtë vit kemi vazhduar përgatitjen dhe adaptimin e shkollave që të jenë të përshtatshme për të gjithë nxënësit pa përjashtim, me theks të veçantë për nxënësit e komuniteteve jo shumicë.
Sikurse në vitin e kaluar, edhe në këtë vit nxënësit janë pajisur me tekstet shkollore të cilat i ka financuar Ministria e Arsimit, edhe në vitet e kaluara kanë aplikuar përmes sistemit e-Kosova, ku drejtorët e Shkollave dhe gjithashtu stafi mbështetës i shkollave kanë asistuar qoftë nxënësit e komuniteteve jo shumicë apo edhe të tjerët në mënyrë që të aplikojnë dhe të realizojnë mjetet financiare për blerjen e teksteve shkollore. Përveç tyre Drejtoria e Arsimit ka vazhduar gjatë pushimit veror në renovimin e objekteve të shkollave dhe një ndër ato dhe që frekuentohet shumë me një numër të madh nxënësish të komunitetit jo shumicë përkatësisht ashkali është shkolla "Dr. Ibrahim Rugova" ku në këtë shkollë janë bërë kushte më të përshtatshme, si dhe po ashtu në atë shkollë kemi formuar edhe Qendrën e Autizmit ku janë punësuar 6 asistent për fëmijë me nevoja të veçanta, si dhe po ashtu në këtë shkollë kemi edhe pedagog dhe psikolog si dhe asistent për fëmijë me nevoja të veçanta.
Pra përveç stafit të mësimdhënësve do të ketë edhe staf mbështetës sidomos në këto shkolla ku janë nxënësit e komuniteteve jo shumicë. Aktualisht në Komunën e Podujevës vijojnë mësimin të gjithë nxënësit e komuniteteve jo shumicë pa përjashtim, dhe për dallim nga komunat tjera ne nuk i ndajmë ata dhe nuk i vendosim në klasa të veçanta por i akomodojmë në klasa të rregullta.
Kemi pas disa raste ku ka qenë prezent edhe Kryesuesi i këtij Komiteti z.Xhafer Ademi ku nxënësi i gjinisë femërore është ulur me nxënësin e gjinisë mashkullore, pra ne nuk i kemi këto paragjykime dhe vazhdojmë të punojmë çdo ditë që të kemi kushte sa më të mira për mësimdhënie dhe mësim nxënie për të gjithë nxënësit pa dallime.
**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, faleminderit për informatën i nderuar, mirëpo më intereson nëse keni ndonjë statistikë konkrete lidhur me këtë.
**z.Ardian Emini**, zyrtar në DKA, theksoi, realisht ka lëvizje të nxënësve nëpër shkolla ku disa shkojnë në shkollat "Naim Frashëri dhe "Shaban Shala". Realisht mbi 160 nxënës të komuniteteve jo shumicë janë që vijojnë mësimin në shkolla siç janë shkollat "Ali Ajeti" në fshatin Sfeqël, "Naim Frashëri" dhe "Shaban Shala" në Podujevë, pastaj në shkollat e fshatrave Batllavë dhe Orllan, si dhe po ashtu në shkollën "Dr. Ibrahim Rugova" në Podujevë.
**z.Ardi Hasani**, theksoi, për këtë vit ndonëse është pak herët sepse është fillimi i vitit, por për vitin e kaluar a keni evidencë sa nxënës janë të cilët kanë qenë duke vijuar mësimin dhe deri në fund të vitit e kanë ndërprerë, pra a ka raste të njëjta dhe nëse ka cilat kanë qenë arsyet.
**z.Ardian Emini**, zyrtar në DKA, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, ka pasur 2-3 raste si tentim për ta ndërprerë shkollimin por së bashku me z.Xhafer Ademin që është edhe Kryesues i këtij Komiteti, dhe drejtorin e shkollës si dhe organet mbështetëse të shkollës kemi shkuar në shtëpitë e atyre nxënësve dhe i kemi kthyer në procesin mësimor, shumica nga këta nxënës e kanë

gjendjen ekonomike jo të mirë dhe që ka qenë si shkak apo arsye e tentimit për ta ndërprerë shkollimin, përndryshe nuk ka kurrfarë diskriminimi apo paragjykimi ndaj tyre, mirëpo shumica e kanë nga gjendja ekonomike.
**z.Ardi Hasani**, sërish theksoi, e kam edhe një nën pyetje nëse më lejohet, tek rastet që u përmenden të cilat janë si shkak i çështjes ekonomike, qysh zgjidhen këto.
**z.Ardian Emini**, zyrtar në DKA, sërish përgjigje për parafolësin, theksoi, rastet e cekura thuajse zgjidhen së bashku edhe me Qendrën për Punë Sociale si dhe përmes ndihmës sociale, pra mundohemi t'i gjejmë format e duhura që t'ju mundësohet atyre nxënësve kthimi në shkolla, madje ka raste që i'u themi se do t'ju ndalet edhe ndihma sociale vetëm e vetëm me qëllim që t'i nxisim të kthehen në shkolla.
**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, falënderoj të gjithë sepse të gjithë kanë qenë të interesuar dhe sidomos drejtorët e shkollave të cilët na kanë bërë thirrje neve si përfaqësues të komuniteteve dhe kemi qenë bashkërisht në këtë proces dhe së bashku me zyrtarët kompetent të Komunën kemi shkuar në shtëpitë e atyre nxënësve të cilët kanë pasë tentim për braktisje të shkollimit, pra kemi ndërmarrë masa dhe kemi arritur pothuajse të gjithë t'i kthejmë në proceset mësimore për çka konsideroj se kemi pasë sukses, madje madje siç e ceku edhe parafolësi e që nuk është e lejueshme nga ne, i'u kemi thënë që do t'jua ndalojmë edhe ndihmën sociale atyre familjeve që nuk i dërgojnë fëmijët e tyre në shkolla, kjo si çështje shumë e ndjeshme për aty familje, pastaj prindërit e tyre menjëherë kanë pranuar që t'i dërgojnë në shkollë fëmijët e tyre.
Përndryshe nuk kam ndonjë informatë që ndonjë nxënës e ka braktisë shkollimin, të paktën zyrtarisht nuk ka, dhe nuk jam i informuar që ka ndonjë rast, mirëpo këtë do ta evidentojmë edhe gjatë vizitave që do të bëjmë nëpër shkolla si anëtar të Komitetit për Komunitete, vizita nga të cilat do të marrim shënime dhe të dhëna rreth gjendjes së nxënësve të komuniteteve jo shumicë në shkollat e Komunës së Podujevës.
**z.Ardian Emini**, zyrtar në DKA, natyrisht se në rast se mund të ketë ndonjë rast të tillë sigurisht që bashkërisht do të ndërmarrim masa që ata nxënës të kthehen në procesin mësimor të rregullt. Kjo meqë tani ende është vetëm fillimi i vitit shkollor dhe nuk mund të dihen sakt a ka raste të tilla, por me kalimin e kohës mund të dihen apo edhe të ketë ndonjë rast të tillë e që ne sigurisht që në çdo rast bashkërisht edhe me juve do të ndërmarrim të gjitha masatë nevojshme për kthimin e tyre në procesin mësimor.
**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, në këtë kontekst unë kam rast konkret ku drejtori i shkollës "Naim Frashëri" në Podujevës më ka telefonuar direkt për një nxënës i cili nuk kishte shkuar për 1 muaj në shkollë dhe menjëherë kemi ndërmarrë masa duke arritur ta kthejmë në shkollë atë nxënës, ka qenë rast ku dy vajza i ka marrë prindi i tyre në punë për të punuar dhe e kanë lënë shkollën, kështu që me t'u njoftuar kemi arritur t'i kthejmë në procesin mësimor dhe të vazhdojnë shkollimin, rast për të cilin është në dijeni edhe shefi i ZKKK z.Liman Zeqiri i cili i ka edhe emrat e tyre dhe të dhënat tjera, pra e konsideroj se kemi pas sukses në këtë aspekt dhe kemi bërë një punë të mirë sepse nuk i kemi lënë rrugëve ato vajza.
**z.Ardian Emini**, zyrtar në DKA, është vërtetë ajo që u tha nga Kryesuesi i Komitetit sepse për raste të tilla paraprakisht shkolla i shteron të gjitha mundësitë qoftë përmes drejtorit të shkollës qoftë kujdestarit apo edhe organeve tjera të vetat, madje nëpër shkolla nga ana e drejtorit të shkollës formohen edhe komisione enkas për mos braktisje të shkollimit, pra fillimisht shkollat i ndërmarrin fillimisht të gjitha hapat paraprak dhe nëse e shohin që nuk po kanë efekt në këtë aspekt atëherë e rastin e delegojnë tek organet më të larta e që pastaj të gjithë së bashku mundohemi të merremi me atë rast ashtu siç kemi vepruar dhe asnjë nxënës nuk ka mbetur jashtë procesit mësimor.

**znj.Sevdije Mustafa**, theksoi, kërkoj nga ana juaj që t'i informoni nxënësit e komuniteteve jo shumicë që janë në shkollën "Shaban Shala" që mësimi shtesë mbahet në shkollën "Naim Frashër" dhe mund t'a ndjekin atë mësim shtesë në atë shkollë, kjo ngase sa jam në dijeni unë atje tani nuk ka nxënës të komuniteteve jo shumicë, më herët kanë qenë, prandaj do të doja që edhe ata nxënës të komuniteteve jo shumicë të vijojnë mësimin shtesë në mënyrë që suksesi i tyre të jetë tepër më i mirë, e suksesi i tyre sa kam vërejtur nuk është aq i mirë, prandaj e përsërisë së ata nxënës të informohen që në shkollën "Naim Frashëri" mund të shkojnë për mësim shtesë.
**z.Ardian Emini**, zyrtar në DKA, lidhur me këtë që e ceku parafolësja, konsideroj që do ndërmarrim masa dhe do ta realizojmë këtë kërkesë, vetëm se tani është fillimi i vitit shkollor andaj posa të adaptohen paska edhe kjo çështje do të rregullohet.
Më gëzon fakti që në shkollën "Naim Frashëri" është mësimdhënësja përkatëse për mësim shtesë, dhe përveç kësaj kemi edhe 4 qendra tjera nëpër shkolla të ndryshme për mësim shtesë ku ndihmohen dhe asistohen të gjithë nxënësit pa dallime sepse mësimi shtesë organizohet në të përgjithshëm jo vetëm për një komunitet, do të thotë nuk ka kurrfarë diskriminimi në këtë aspekt, kështu që parafolësja është mësimdhënëse dhe e din dhe ka njohuri të mjaftueshme rreth kësaj çështje dhe madje është në dijeni se me çfarë mundi i kemi bërë këto qendra burimore sepse nuk na lejonin më parë, mirëpo tani fatmirësisht është viti i tretë që zyrtarisht vazhdojmë të funksionojmë me mësim shtesë në katër shkolla.
**z.Ardi Hasani**, theksoi, adresimi ishte i mirë, dhe mirë që mora shënime rreth kësaj çështje në mënyrë të merremi me këtë pjesë ashtu siç jeni marrë edhe ju, mirëpo kjo çështje ndoshta i'u takon pak më shumë edhe anëtarëve apo përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë për shkak të sfidave që kanë vetë këta nëpër familjet e tyre, lagjet e tyre e kështu me radhë.
**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, theksoi, u bë një pyetje shumë me vend dhe ju falënderoj për këtë që jeni prezent dhe i keni informacionet e sakta dhe që ka një koordinim të mirë nga niveli më i ulët deri te niveli më i lartë sa i përket arsimit në Komunën e Podujevës dhe drejtorisë së arsimit në këtë Komunë. Unë jam edhe anëtar i komisionit për mos braktisje, në kuadër të Komunës dhe atë në bazë të funksionit që kam, kryesues i komisionit është z.Blerim Vllasa i cili është zyrtar i DKA-së me të cilin kemi vizituar të gjitha shkollat thuajse. Në vitin e kaluar kemi pasë 4 raste, dhe tani kemi hierarkinë e shkollave, 2 raste kanë qenë në shkollën "Dr. Ibrahim Rugova" dhe 2 raste në shkollën "Naim Frashëri", raste për të cilat ka qenë në dijeni edhe z.Xhafer Ademi i cili ndoshta është edhe më kompetent të flas sepse është edhe përfaqësues i komuniteteve jo shumicë, njëri prej rasteve ka qenë në klasën e VIII-të, arsyet kanë qenë nga më të ndryshmet (për t'u kujdesur për gjyshen dhe të ngjashme), por meqë ka qenë fundi i vitit dhe në klasën e VIII-të dhe të IX-të paska na ka brengosur, mirëpo kemi edhe rastet ekonomike dhe sociale, mirëpo edhe çështja tjetër që i dim thuajse tek komunitetet jo shumicë e që thënë të vërtetën, këtu kemi edhe përfaqësues të komuniteteve jo shumicë, normale që është një barrë paska më e madhe shtesë nëse mund ta quaj kështu kushtimisht dhe e kam fjalën më shumë te gjinia femërore, pastaj kemi edhe kujdesin ndaj familjes dhe anëtarëve të familjes, dhe megjithatë e marrin pastaj si shkas, por megjithatë në bazë të komunikimeve e që së pari është drejtori i shkollës, është komisioni për mos braktisje, që është brenda shkollës, është këshilli i prindërve, pastaj vijnë organet më të larta që është Drejtoria e Arsimit dhe Komisioni i veçantë për mos braktisje në kuadër të Komunës, dhe në koordinim me krejt këto organe kemi arritur t'i kthejmë ata nxënës në bankat shkollore duke i vizituar ato familje dhe duke biseduar drejtpërdrejt me prindërit e tyre, pra çështja jonë ka qenë në kuptimin e ndërmjetësimit prindër dhe fëmijë e që unë kam qenë vetë prezent në dy-tri raste ku kemi biseduar edhe me prindërit e tyre për t'i kthyer ata nxënës në procesin mësimor, arsyeja është shumë e thjesht sepse shkolla e mesme e ulët është shkollim obligativ dhe përgjegjësinë e merr edhe prindi

përse është ndalë djali apo vajza prej shkollës, ndërsa shkolla e mesme e lartë pastaj është shkollë që nuk është obligative e që mund të shkoj ose jo në shkollë, është alternative, mirëpo detyrimi jonë si institucione që jemi neve na dërgon mesazh që jemi të deleguar dhe përveç kësaj kemi edhe obligim, madje sanksionohemi në qoftë se nuk marrim veprime adekuate për t'i kthyer ata nxënës në bankat shkollore sepse kemi obligim qysh nga drejtori i shkollës, komisionit për mos braktisje në kuadër të shkollës, këshillit të prindërve, por që normale që përgjegjësia më e madhe pastaj vie në nivel pak më të lartë që është Drejtoria e Arsimit, prandaj shumë mirë që u shtrua kjo pyetje nga i nderuari anëtarë i këtij Komiteti dhe i Kuvendit të Komunës që kjo është përgjegjësi e jona kolektive, por më shumë po e quaj në atë kuptimin institucional.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, falënderoj Nënkryetarin e Komunës i cili na u bashkëngjitur në këtë mbledhje, vetëm dua të shtojë edhe diçka rreth kësaj që e potencoj z.Liman Zeqiri se problemin kryesor e kemi pasë me një vajzë të komunitetit jo shumicë e cila ka qenë në shkollë të mesme, madje maturante, mirëpo shkaku kryesor i tentim ndaljes nga procesi i shkollimit ka qenë prindi i saj dhe ka ndodh kjo për rreth 1 muaj e që konsideroj se është paska kohë e gjatë, kështu që bashkërisht me z.Liman Zeqirin kemi arritur me shumë mund, madje në një formë edhe me kërcënime se do të ftohet nga policia ai person për shkak të ndaljes nga shkolla vajzën e vet, dhe kemi arritur ta bindim që ta lejoj vajzën e vet të vazhdoj shkollimin e cila edhe tani është duke vazhduar shkollimin.

Mund të them se në një farë forme tek ne komunitetet jo shumicë është si traditë që nxënësit tanë kur e kryejnë shkollimin fillor pastaj regjistrohen në shkolla të mesme dhe në këtë aspekt në këtë vit nuk kemi pas probleme për çka i falënderoj edhe drejtorët e shkollave të mesme të cilët po jua mundësojnë atyre regjistrimin edhe pse ndoshta ka raste që nuk i plotësojnë të gjitha kriteret ndonjëherë, e që nganjëherë po duhet me drejtorët e shkollave të bashkëpunojmë në këtë aspekt.

**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, theksoi, lidhur me çështjen në fjalë që është paksa më e veçantë dhe mund ta pyesni edhe drejtorin e DKA-së z.Avni Fetahu të cilin e falënderoj dhe kam respekt, pra përveç notave të mira në shkollimin fillor aty pastaj janë edhe disa kritere me poena sepse janë disa profesione paksa më adekuate e që varet edhe suksesi por duke pasë edhe mirëkuptimin te komunitetet jo shumicë në Komunën e Podujevës ngase mund të them se integrimi i komuniteteve në shoqëri është pasuria më e madhe e një shoqërie që jeton, madje ne e kemi edhe me Kushtetutë që duhet ta nderojmë dhe ta mbrojmë me respektin më të madhe që të jemi në mbrojtje të tyre sepse janë pakicë, kjo ngase ne si popull e kemi përjetuar këtë në kohëra tjera të mëparshme por që nuk dëshiroj të kthehem në histori, mirëpo nga kjo konsideroj se e kemi edhe një obligim shtesë moral për t'ju dalë në krah komuniteteve jo shumicë në mënyrë që ata të mos e ndiejnë veten të diskriminuar, andaj unë në kuadër të kësaj kam insistuar, por duke e falënderuar edhe drejtorin e DKA-së, edhe shkollën ekonomike janë dy vajza të cilat janë regjistruar në drejtimin e mjekësisë ku siç e dini aty janë disa kritere më strikte për shkak se ka kërkesa më të mëdha dhe në kuadër të atyre poenëve të barabartë ju kemi dhënë mundësi dhe sot ato vajza janë ndër nxënëset më të mira, për këtë kam informacione prej shkollës ekonomike që ato vajza kanë treguar një kulturë, një edukatë dhe një mësim që janë shembull për të mirë, çështje kjo e cila e pasuron diversitetin tonë që ne jemi për t'i ndihmuar, për t'i respektuar dhe për t'i ngritur e që do ta bëjmë çdo herë sepse e kemi edhe obligim, mirëpo është edhe kënaqësi kur shohim rezultatet e tyre pastaj. Vlen të theksohet se këtu prezentë kemi edhe këtë vajzën (Dorontina Tahiri) e cila ka qenë në shkollën ekonomike, pastaj ka bërë praktikë në Komunë dhe tani është anëtare e këtij Komiteti, e që është pasuri për neve sepse janë duke u shkolluar.

Arsyeja është shumë e thjeshtë sepse ne së bashku me z.Xhafer Ademin nga pas lufta tash jemi rreth 26 vite me aktivitete të ndryshme dhe e dim që ka qenë numër shumë i vogël i komuniteteve

jo shumicë që janë shkolluar, mirëpo pas luftës kemi një numër aq të madh që është rritur e që tani më veç kanë kryer edhe shkollime të larta ngase për shkollim të mesëm normale që nuk kanë pasë asnjëherë pengesa, prandaj kjo për ne si Komunë e Podujevës, e që unë gjithherë i plasoj këto të dhëna edhe në organet shtetërore dhe nëpër tryeza të ndryshme se Podujeva duhet të krenohet që asnjëherë kurrë nuk ka pas ndonjë diskriminim, nuk po them për vende tjera, mirëpo lirshëm mund të them se jemi Komuna më e mira për integrimin, madje unë këtë termë tani së fundmi e ka zëvendësuar me termin avancim i të drejtave të të gjithë qytetarëve pa dallim ngase ne bashkëjetojmë, jemi bashkë dhe duhet t'i ndihmojmë komunitetet që mendojmë se janë pa më të pafuqishëm, kurse ne që mendojmë që jemi "dikushi" atëherë e tregojmë veten kur i'a shtrijmë dorën, andaj kjo është më e mira që në Komunën e Podujevës asnjëherë nuk ka pasë ndonjë diskriminim, madje mund të them se disa raste ka pas diskriminim pozitiv në aspektin e avancimit të të drejtave të komuniteteve jo shumicë.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, parafolësi më kujtoj që kur unë kam qenë mediator i arsimit për 4 vite në Komunën e Podujevës nga një Organizatë që ka qenë "Ballkan Sun Flowers" e cila ka monitoruar në krejt Kosovën, kështu që kur kishim takime të gjithë mediatorët e kësaj Organizate e cila ka qenë mjaftë e njohur në atë kohë, ne Podujeva gjithherë jemi vlerësuar më e mira dhe jemi marrë si shembull, madje madje kur merrja fjalën unë dhe tregoja disa situata dhe çështje të ndryshme rreth komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës, disa të Komunave tjera kishin habi dhe pyetshin se a është mundur të ndodh një gjë e tillë në Podujevë në krahasim me qendrat tjera të Kosovës, kështu që për t'u vërtetuar ajo punë pati ardhur komision i posaçëm, kjo duke menduar që mos rastësisht unë po rriti më shumë punën, pra ai komision e ka vërtetuar se ashtu ka qenë, madje më kujtohet një rast kur më kanë thënë që në komuna tjera na duhet të bëjmë termin për takim me drejtorët e shkollave, kurse unë nuk kisha nevojë të bëjë fare terminë qoftë te drejtori i DKA-së, qoftë te drejtorët tjerë, pastaj as te drejtorët e shkollave as askund, pra ai komision i posaçëm pati ardh pa paralajmërim dhe në befasi më ka marrë dhe kemi dalë në terren dhe nëpër institucione e që nga kjo pastaj jemi shpallë Komuna më e mirë në gjithë Kosovën, me theks në arsimimin e komuniteteve jo shumicë, dhe fakt kemi qenë ashtu sepse suksesi ka qenë i mirë.

**z.Rrahim Sejdiu**, theksoi, në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr."Xhafer Meta" në këtë vit janë regjistruar në parashkollor gjithsej 3 nxënës, pastaj në mësimin fillor nga klasa e I-rë deri në klasën e IX-të janë duke vijuar shkollimin nëse nuk gaboj 69 nxënës, mandej në shkollim të mesëm nga kjo lagje kemi momentalisht 8 nxënës, 2 vajza janë duke vijuar shkollim në fakultet, dhe kemi 1 që e ka përfunduar fakultetin.

Kam një kërkesë që nëse nga Komuna ka ndonjë ndihmë ose ndonjë bursë për nxënësit e komuniteteve jo shumicë që janë në shkolla të mesme, do të ishte shumë mirë të përkrahen, kurse për nxënësit e shkollave fillore mund të themi se nuk kanë nevojë diçka në këtë aspekt sepse për libra i ka ndihmuar Ministria edhe pse nuk ka mjaftuar ajo ndihmë sepse është dashur mjete shtesë për fletore, çanta dhe pajisje tjera mësimore.

**z.Ardian Emini**, zyrtar në DKA, viteve paraprake planifikonim mjete buxhetore për subvencionime të librave dhe pajisjeve tjera për nxënësit e shkollave të mesme, por meqë ka pas ndryshim të kurrikulës dhe ka ndodhë që librat mandej të mos jenë adekuate për ata nxënës dhe na mbeteshin në sirtar ato libra, kjo ka qenë arsyeja që nuk kemi vazhduar edhe tutje të ndajmë mjete financiare për subvencionimin e librave dhe elementeve tjera shkollore për nxënësit e shkollave të mesme të cilët kanë qenë me gjendje jo të mirë ekonomike dhe financiare. Pra vetëm shpenzonim kot thuajse në këtë aspekt.

Ne e kemi një Rregullore për ndarjen e subvencioneve ku pjesë e saj janë edhe bursat për student, mirëpo për nxënës të shkollave të mesme nuk e kemi ende një gjë të tillë për shkak të këtyre

rrethanave që i ceka, mirëpo do të shikojmë mundësitë se çfarë mund të bëjmë në vitet e ardhshme që t'i nxisim dhe t'i fusim në projektbuxhet edhe këtë pjesë edhe pse buxheti për vitin e ardhshëm thuajse është në përfundim e sipër, por në vitet e ardhshme do të shohim se çfarë mund të bëjmë.
**Kryesuesi i Komisionit**, theksoi, meqë nuk të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë dhe e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

3. **Informatë e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim - ZKKK rreth vazhdimit të Memorandumit të Mirëkuptimit në mes Komunës së Podujevës dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migrim-IOM, financuar nga programi i BE-së për mbështetjen e bizneseve të vogla në kuadër të komponentës për stabilizimin e Komuniteteve jo shumicë.**

**z.Liman Zeqiri**, Shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim - ZKKK, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, përshëndeti të pranishmit, me theks Nënkryetarin e Komunës z.Fahri Restelica i cili ka gjete kohë për të qenë prezent në këtë mbledhje, në vazhdim ndër të tjera theksoi, rreth kësaj çështje kemi tre faktor këtu që janë për të mirën e komuniteteve jo shumicë që janë Komuna, IOM dhe BE, me të cilat si Komunë kemi një bashkëpunim të mirë vite me radhë e që lirshëm mund të them për 20 vite që kemi një Memorandum të Bashkëpunimit të cilin e kemi vazhduar, e që prej 37 Komunave të Kosovës, në mesin e 10 Komunave jemi edhe ne si Komunë e Podujevës që bashkë financojmë projekte të ndryshme me Bashkësinë Europiane dhe në bashkëpunim me IOM e cila është Organizatë Ndërkombëtare e cila merret enkas me stabilizimin, zhvillimin dhe ndihmën për komunitetet jo shumicë, dhe duke u bazuar në këtë Organizatë me të cilën kemi pasë bashkëpunim përmes Memorandumit, ne si Komunë kemi pasë përfitime të mira në të gjitha etapat kohore qoftë në çështjet e infrastrukturës, çështjes së shkollave e që mbi 12 persona për vite me radhë kanë përfituar, madje tani jua shpërndaj këtë dokument sipas të cilit deri më 30 shtator është afati i aplikimit, dhe të gjithë ata individ të komuniteteve jo shumicë të cilët kanë qenë përfitues më parë por edhe që tani aplikojnë Konkursi është i hapur që të aplikojnë për ndonjë ide, projekt, biznes që mund të merren me atë biznes të vogël familjarë dhe që në kuadër të të cilit mund të krijohen edhe vende të punës si dhe të gjeneroj edhe të hyra familjare por edhe për punëtorët tjerë si dhe me shpresë që ta rritë biznesin qoftë në biznes të mesëm apo edhe në biznes të madh pse jo varësisht aktiviteteve dhe llojit. Në shumicën e rasteve kemi pasë anën pozitive në këtë aspekt ku ka pas përfitues që kanë përfituar dhe janë rritur, por ka pasë edhe të atillë që e kanë shfrytëzuar këtë mundësi atë beneficion dhe ato mjete pune. Unë së bashku me Kryesuesin e këtij Komiteti z.Xhafer Ademi si dhe me zyrtarin e IOM kemi qenë në komision dhe kemi vizituar persona të ndryshëm për t'jua dhënë ato mjete pune nga të cilat shumë perona kanë punuar, janë zhvilluar dhe janë rritur si biznes duke ju ndihmuar edhe të tjerëve, por ka raste siç e ceka që ndoshta nuk i kanë futur fare në funksion ato mjete përfituese.
Në kuadër të kësaj donacioni mund të jetë 3000.00€; 4000.00€ apo edhe 5000.00€, me një pjesëmarrje të vogël në përqindje e që në disa raste e kemi eliminuar edhe atë pjesëmarrje të cilën e ka dhuruar IOM e cila është implementuese e fondeve të Bashkësisë Europiane, si dhe kjo Organizatë njëkohësisht luan edhe rolin e një lloj ndërmjetësuesi e cila verifikon situatën dhe bënë vlerësimin dhe nënshkrimin e dokumenteve për peronat përfitues.
Unë apeloj që deri më 30 shtator, kushdo që ka ndonjë aktivitet që mund të vijë deri te punësimi dhe që mund të merre mjete nga ky konkurs dhe nga këto fonde të BE-së për tri komunitetet jo

shumicë Ashkali, Rom dhe Egjiptas, e që vlen të theksohet se e kam kontaktuar përfaqësuesin e Komunitetit Rom z.Muhamet Sadikun sepse këta kanë përfituar më pas, të jemi të sinqertë, dhe e kam inkurajuar që ndokush nga ky komunitet të aplikoj nëse veç ka të tillë që mund t'i plotësojnë kriteret sepse janë disa të tilla që pastaj i verifikon komisioni përkatës, andaj apeloj që të konkurroni në këtë konkurs.
Ajo që mua më ka zgjuar një kureshtje që të flas edhe tani para juve këtu, sepse Memorandumin e Mirëkuptimit e nënshkruar Kryetari i Komunës, mirëpo unë jam një lloj nikoqiri apo një ndërmjetësues që i përkrahë dhe i'u ndihmoj komunitetet jo shumicë sipas funksionit të Zyrës.
Vlen të theksohet se 7 shkolla të Komunës së Podujevës janë pajisur me kabinete të cilat i kanë kërkuar me të gjitha pajisjet si kabinete më moderne e që ne duhet të mburremi më këtë, qoftë kabinete për gjeografi, histori, biologji, kimi, informatikë, pastaj kabinete me vegla muzikore, dhe çka do që i është dashtë një shkolle për një kabinet të rëndësishëm është pajisur në bazë të kërkesave të tyre e që nga kjo kanë përfituar të gjithë nxënësit. Do të thotë ne duhet t'i falënderojmë nxënësit e komunitetit jo shumicë që kanë qenë në numër më të vogël, por që përfitimi ka qenë më i madhi i të gjithë nxënësve ku janë edhe nga komuniteti shumicë që kanë përfituar. Në qoftë se e marrim shkollën "Dr. Ibrahim Rugova" ku në vitin e kaluar kanë qenë rreth 70 nxënës të komuniteteve jo shumicë dhe ndoshta 700 të komunitetit shumicë, sigurisht që ka përfituar e gjithë shkolla, do të thotë ne duhet të mburremi me këtë, është pasuari shumë e madhe e jona dhe duhet t'ju falënderohemi edhe nxënësve të komuniteteve jo shumicë nga të cilët përfitojnë edhe komuniteti shumicë nga kabinetet që janë shumë të nevojshme për teknologjinë e sotit për ta arritur anën praktike sepse kjo e kalon teorinë, kur e ke teorinë dhe praktikën atëherë nxënësi bëhet shumë i dijshëm, më inteligjentë dhe mbërrin shkallën e dijes që e meriton.
Në këtë ka përfituar edhe SHFMU "Naim Frashëri" me kabinete, pastaj shkolla "Shaban Shala", shkolla "Dr. Ibrahim Rugova", shkolla "Zahir Pajaziti" në Orllan, shkolla "Luigj Gurakuqi" Batllavë, shkolla "Ali Ajeti" në Sfeçël dhe shkolla "Fan S. Noli" në Podujevë e cila ka përfituar me mjete buxhetore rreth 14,000.00€ ose 15,000.00€ por do të ishte mirë që edhe ato shkolla të cilat nuk kanë përfituar e që kanë nxënës të komunitetit jo shumicë siç është edhe shkolla "Xheladin Rekaliu" për t'i përthekuar në një farë mënyre.
Po ashtu kemi edhe anën tjetër të konkursit që e ceka që kanë të drejtë të aplikojnë dhe të jenë përfitues edhe individë të ndryshëm në projekte të biznesit dhe rritjes së tyre dhe krijimit të vendeve të punës dhe të ndihmohen sepse me ngritjen e tyre ne vetëm pasurohemi të gjithë e që na vyen edhe neve edhe atyre kjo gjë, prandaj unë ju shpërndava këtë dokument me të cilin mund të konkurroni, aty është edhe numri kontaktues që mund të kontaktoni personat përkatës, madje vlen të theksohet se gjinia femërore në këto projekte merret shumë parasysh tek financuesit dhe është mirë të ketë konkurrime sa më shumë të jetë e mundur për ndonjë ide, projekt apo diçka të ngjashme siç është rrobaqepësi, dekorime e të tjera të ngjashme duke përfshirë edhe ndonjë ide në kuptimin bujqësorë që mund të konkurrojnë dhe të jenë përfituese.
Kjo ishte ajo që unë deshta t'ju informoj si shef i ZKKK në Podujevë, por nëse ka diçka të paqartë ose që ndonjë sqarime shtesë unë jam këtu dhe mund ta diskutojmë.
**z.Xhafer Ademi**, **Kryesues i Komitetit**, theksoi, ju falënderoj i nderuar Liman për këtë informatë që e paraqite, ne komuniteti jo shumicë që jetojmë në lagjen në rrugën "Ali Ajeti" këtë konkurs e kemi shpërndarë dhe i kemi inkurajuar të aplikojnë, pra komuniteti jo shumicë në atë lagje është në dijeni për këtë konkurs, po ashtu edhe për afatet, projektet dhe çështje tjera, kështu që besoj se do të ketë aplikime ata të dëshirojnë sepse i kemi shpërndarë dhe publikuar ato konkurse në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rrugën "Ali Ajei" dhe po ashtu edhe në rrugën "Xhafer Meta" apo "Skënderbeu", ndërsa për lagjet ku jetojnë komuniteti jo shumicë në fshatrat Batllavë dhe

Orllan sot jua dhashë përfaqësuesve të tyre që janë anëtar të këtij Komiteti dhe besoj se do t'i njoftojnë, afati është deri më 30 të këtij muaji dhe mund të aplikojnë me projektet e tyre.
Urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e konstatojmë të përfunduar edhe këtë pikë të rendit të ditës.

## 4. Të ndryshme

**z.Xhafer Ademi**, **Kryesues i Komitetit**, theksoi, kemi edhe disa vizita që duhet t'i bëjmë nëpër shkollat e Podujevës, andaj ju pyes se kur mendoni t'i vizitojmë, pra në Plan të punës e kemi këtë aktivitet por nuk është e përcaktuar data dhe koha se kur, andaj urdhëroni mund të jepni propozime kur mund t'i bëjmë këto vizita në shkollat e Podujevës, kurse në shkollat e fshatrave po lëm në ndonjë ditë apo muaj tjetër.
Pra në këto vizita do ta shohim gjendjen reale të nxënësve të komuniteteve jo shumicë në shkollat e Podujevës. Bëhet fjalë për të gjithë anëtarët e këtij Komiteti sepse sipas Planit të punës i kemi paraparë këto vizita që të bëhen në shkollat e Podujevës duke përfshirë edhe shkollat e fshatrave, mirëpo mund të na bashkëngjitet edhe ndokush nga Komuna siç është z.Liman Zeqiri por edhe Nënkryetari i Komunës i cili tani veçse e konfirmoj këtë se do të jetë pjesë e këtij aktiviteti.

*Pas diskutimeve në mes anëtarëve të Komitetit, me unanimitet vendoset që më datën 23 të këtij muaji, të bëhen vizitat e anëtarëve të Komitetit për Komunitete në shkollat e Podujevës, me qëllim që të shikohet gjendja aktuale dhe reale e nxënësve të komuniteteve jo shumicë në shkollat e Podujevës. Vendtakimi i anëtarëve të bëhet këtu në ambientet e Komunës në ora 10:00.*

*Konstatohet e përfunduar kjo mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 10:50**

**Procesverbalin e mbajti,**
**Arbrim Idrizi**

**Nr.Prot.01-016/01-0058323/26**
**Podujevë, 18 shtator 2026**

**Kryesuesi i zgjedhur e Komitetit**
**Xhafer Ademi**